



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

***Fjalimi i Rektorit Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku në Ceremoninë e Diplomimit të Studentëve***

I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti,  
E nderuar Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, znj.  
Arbërie Nagavci,  
I nderuar Kryetar i Komunës së Gjilanit, z. Alban Hyseni,  
E nderuar dhe e respektuar Familje Zeka,  
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga rajoni i  
Anamoravës,  
Të nderuar përfaqësues të institucioneve publike, profesorë, prindër, familjarë,  
dhe mbi të gjitha ju të dashur studentë të diplomuar,

Është kënaqësi e veçantë dhe nder i madh për mua, si Rektor i Universitetit Publik "Kadri Zeka", që sot të jem para jush në këtë ditë të shënuar, një moment që shënon një arritje të rëndësishme në jetën tuaj por edhe në historinë e institucionit tonë.

Sot, pas një rrugëtimi të gjatë studimesh, përkushtimi dhe përpjekjesh të pareshtura, ju po kurorëzoni suksesin tuaj me diplomën universitare. Kjo diplomë nuk është vetëm një dokument, por dëshmi e punës suaj, e sakrificave të familjeve tuaja dhe e mbështetjes së stafit tonë akademik, i cili ka qenë pranë jush gjatë gjithë kësaj periudhe.

Universiteti Publik "Kadri Zeka" gjatë këtyre viteve ka shënuar suksese të rëndësishme që na bëjnë krenarë. Një ndër arritjet më të mëdha është

akreditimi institucional për 5 vite, që dëshmon për cilësinë e lartë të arsimit që ofrojmë dhe për seriozitetin tonë në misionin akademik. Kemi zgjeruar programet studimore, kemi forcuar hulumtimin shkencor dhe kemi krijuar bashkëpunime ndërkombëtare që i japin studentëve tanë mundësi të shkëlqyera për zhvillim profesional. Studentët tanë kanë marrë pjesë dhe kanë fituar suksese në gara, olimpiada dhe projekte shkencore, ndërsa profesorët dhe studiuesit tanë kanë kontribuar me punime e prezantime në konferenca dhe revista prestigjioze.

Megjithatë, përveç këtyre arritjeve, ne përballemi edhe me sfida konkrete. Ndërtimi i kampusit universitar është një prioritet i madh, sepse studentët tanë meritojnë kushte moderne për mësim, hulumtim dhe zhvillim social. Gjithashtu, mbetet sfidë rritja e kapaciteteve laboratorike dhe teknologjike, si dhe sigurimi i fondeve për projekte shkencore. Këto sfida janë mundësi për të përmirësuar dhe për t'u bërë më të fortë si institucion.

Studentë të dashur, mos harroni se ky moment nuk është fundi i rrugëtimit tuaj, por fillimi i një kapitulli të ri. Përballë jush do të hapen sfida të reja, por edhe mundësi të shumta. Disa nga ju do të bëheni inxhinierë e do të projektoni softuere, disa rrugë e sisteme që lidhin njerëzit. Disa do të bëheni gjyqtarë e do të sillni drejtësi aty ku shoqëria ka më shumë nevojë. Disa do të bëheni mësues e do të ndizni dritën e diturisë tek gjeneratat që vijnë. Disa do të jeni ekonomistë që do të zhvillojnë tregun dhe mirëqenien e vendit. E pse jo, dikush nga ju do të bëhet kryetar komune, e dikush kryeministër i ardhshëm. Por rrënjët e këtij rrugëtimit të madh i keni këtu – në Universitetin “Kadri Zeka”.

Ky universitet nuk është vetëm një institucion arsimor. Ky universitet është perspektivë, është krenari, është dritë për këtë shoqëri. Nga viti 2014 e deri më sot, kemi diplomuar rreth 2300 studentë ku mbi 2000 në studimet bachelor dhe rreth 300 në nivelin master. Çdo diplomë është një dritë e re që ndriçon Kosovën.

Filozofi grek Aristoteli ka thënë: “Rrënjët e arsimit janë të hidhura, por frutat e tij janë të ëmbla.” Ju sot jeni dëshmia më e gjallë e këtyre fjalëve. Çdo orë studimi, çdo provim, çdo sakrificë, sot shndërrohet në gëzim, në krenari dhe në shpresë për të ardhmen, jo vetëm tuajën por të gjithë shoqërisë.

Po ashtu, Platoni ka theksuar se “Dija është forca më e madhe që mund të udhëheqë një shoqëri.” Ju, të dashur studentë, jeni pikërisht ajo forcë e re që do ta udhëheqë vendin tonë drejt zhvillimit, drejt drejtësisë, drejt integritit dhe drejt një shoqërie më të drejtë.

Universiteti ynë është shtëpia ku ëndrrat e juaja marrin formë. Është vendi ku shoqëria jonë sheh të ardhmen e saj. Në këtë ceremoni sot nuk kemi vetëm studentë, kemi themelues të së ardhmes.

Në këtë ditë solemne, dua të shpreh mirënjohje të veçantë për familjet që kanë qëndruar gjithmonë pranë jush me dashuri dhe përkushtim, si dhe për profesorët dhe stafin tonë akademik që me profesionalizëm e pasion kanë ndarë dijen dhe përvojën e tyre me ju.

Të diplomuar të dashur, uroj që diploma e fituar sot të jetë një urë që do t’ju çojë drejt sukseseve të tjera më të mëdha, drejt ëndrrave tuaja dhe drejt realizimit të plotë të potencialit tuaj.

Ju përgëzoj edhe një herë për arritjet e deritanishme dhe ju uroj suksese të pafundme në jetën profesionale dhe personale.

Urime të gjithëve dhe suksese në të ardhmen!

Gjilan, 8 shtator 2025

Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku

R E K T O R